

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Shop Communications” shpk**

Sot, më 01.11.2021, ne, themeluesit,

- a) Mirsida Gropa, atësia Veip, shtetase Shqiptare, identifikuar me anë të Letërnjoftim ID me numër 033812264, me numër personal identifikimi I760050370, e datëlindjes 05.10.1987, lindur në Rrogozhinë dhe banuese në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- b) Paulo Gropa, atësia Novrus, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të Letërnjoftim ID me numër 037286139, me numër personal identifikimi I60120071N, i datëlindjes 20.01.1986, lindur në Fier dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Shop Communications” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
  - a) Tregimi me pakicë i veshjeve, produkteve të kozmetikës, veshmbathjeve dhe produkte të tjera të kujdesit personal: shitja me pakicë e veshjeve të reja dhe të përdorura për të gjitha moshat dhe kategoritë, produkte të kujdesit personal, kozmetikës, të higjienës dhe aksesorë të ndryshëm.
  - b) Ofrimi i shërbimeve të riparimit të veshjeve dhe aksesorëve të ndryshëm.
  - c) Ofrimi i shërbimeve të ndryshme administrative: Ofrim të shërbimeve të marketingut, administrimit, ndërmjetësimi, shërbime të teknologjisë dhe informacionit dhe shërbime të tjera të ndryshme.
  - d) Importi dhe eksporti i veshjeve, aksesorëve, produkteve kozmetike dhe artikujve të tjerë, objekt tregtimi i shoqërisë.
- 2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Njësia Administrative Kashar, Lagjia 14, Rruga “Unaza e Re”, Blloku Nr. 3, Seksioni Nr.4, Kati 0, Zona Kadastrale 3866, Tiranë..
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (Një qind mijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (Dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a) Ortaku themelues Mirsida Gropa, zotërues i 1 (Një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (Pesëdhjetë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
  - b) Ortaku themelues Paulo Gropa, zotërues i 1 (Një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (Pesëdhjetë) Lekë, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**  
**Administratori**

- 1) Administratori i shoqërisë Paulo Gropa, atësia Novrus, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të Letërnjoftim ID me numër 037286139, me numër personal identifikimi I60120071N, i datëlindjes 20.01.1986, lindur në Fier dhe banues në Tiranë; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

**Neni 7**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


**Neni 8**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

\*\*\*

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Shop Communications" shpk**

Mirsida Gropa   
**Mirsida Gropa**  
(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)

Paulo Gropa   
**Paulo Gropa**  
(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)